

## KOMUNA E GJILANIT 2017: PROBLEMET KRYESORE DHE TRENDET BUXHETORE

### Hyrje

Kryetar i Komunës së Gjilanit është Lutfi Haziri nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Ky është mandati i tretë i Hazirit si kryetar i Komunës. Mandati i parë i tij ishte në vitet 2000-2002, kurse mandati i dytë nga viti 2002 deri më 2004, të cilin e ndërpreu në gjysmë për shkak të angazhimit në Qeverinë e Kosovës.

Në zgjedhjet lokale më 2013 për kryetar të komunës. Lutfi Haziri ka fituar në balotazh ndaj kandidatit nga Partia Demokratike e Kosovës, Qemajl Mustafa.

Rreth 58% e qytetarëve të Gjilanit konsiderojnë se komuna mund t'i zgjidhë problemet me të cilat ballafaqohen ata.<sup>1</sup> Dy vite pas marrjes së mandatit të kryetarit, vetëm 24% e qytetarëve janë shprehur të kënaqur me punën e kryetarit Haziri, përderisa vetëm 16% e qytetarëve kanë konsideruar se fondet publike në komunë menaxhohen siç duhet.<sup>2</sup>

Raporti i fundit i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të pjesa e buxhetit konstaton se Gjilani ka mjete në dispozicion që nuk i shfrytëzon dhe i bart në vitin tjetër dhe njëherazi shkalla e mjeteve të papaguara ndaj operatoreve privat është e lartë.<sup>3</sup>

Në prag të zgjedhjeve komunale 2013, Instituti GAP kishte identifikuar problemet kryesore të Komunës së Gjilanit. Ndër problemet më madhore kishin dalë të jenë: mungesa e ujit të pijes dhe cilësia jo e mirë

<sup>1</sup> UNDP. Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

<sup>2</sup> UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 91 & 92. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

<sup>3</sup> Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti për Komunën e Gjilanit. Fq 19. 2015. Burim: <http://bit.ly/2szCsWF> (Qasur me 18.06.2017)

e ujit të pijes, infrastruktura jo e mirë rrugore, kanalizimi dhe kundërmimi i ujerave të zeza, mos menaxhimi i duhur i mbeturinave, mungesa e çerdheve për fëmijë, zvarritja e madhe e projekteve investuese publike, numri i madh i të punësuarave në administratën komunale si dhe rënie e të hyrave komunale dhe hyrja në borxhe tek operatorët privat.<sup>4</sup>

## **Problemet aktuale të Komunës së Gjilanit**

### **Kundërmimi nga deponia e mbeturinave në fshatin Velekincë**

Një ndër problemet më të mëdha me të cilin ballafaqohen banorët e fshatit Velekincë është edhe ndotja e ambientit nga deponia e mbeturinave. Banorët thonë se janë ankuar shtatë herë në komunë, por nuk është ndërmarr asnjë masë për eliminimin e erës së keqe e cila lirohet nga deponia. Banorët e Velekincës tregojnë se një ndër arsyet kryesore përse ka një disponim për largim nga fshati është edhe ndotja e ajrit nga deponia. Përveç kësaj, ky fshat ka mungesë të ambulancës, ndriçimit publik si dhe kanalizimit.<sup>5</sup>

### **Rreziku i mbylljes së qendrës “PENA”**

Komuna e Gjilanit është përzgjedhur në vitin 2013 nga Komisioni Evropian për ndërtimin e një qendre të specializuar për trajtimin dhe socializmin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Kjo qendër është ndërtuar dhe është përkujdesur për trajtimin e 172 fëmijëve që konsiderohen me nevoja të veçanta në këtë komunë. Nga ajo kohë (2013) deri në fund të 2016, kjo qendër ka funksionuar fal donatorëve ndërkombëtarë, por donatorët janë tërhequr duke e lenë përgjegjësinë te autoritetet lokale për menaxhimin e kësaj qendre. Kjo qendër ka gjithsej shtatë persona të punësuar. Komuna ka ndarë një subvencion në vlerë prej pesë mijë eurove në fillim të vitit 2017 por që nuk mbulon as përafërsisht shpenzimet që ka kjo qendër. Udhëheqësit e komunës janë shprehur se e kanë të pamundur të fusin këtë qendër në kode buxhetore dhe këssoj mundësia e mbylljes së saj është e evidente. Komuna e Gjilanit nuk ka ndonjë qendër ose organ tjetër që do të mund të trajtonte rastet e fëmijëve me nevoja të veçanta.

### **Mos rregullimi i rrugës në Kravaricë**

Fshati Kravaricë në komunën e Gjilanit është në mesin e pak fshatrave që nuk e ka të rregulluar (asfaltuar) rrugën kryesore. Banorët e kësaj ane

---

<sup>4</sup> Instituti GAP. Problemet Kryesore dhe trendet buxhetore të Komunës së Gjilanit 2013. Burim: <http://bit.ly/2rBQVjy>

<sup>5</sup> Problemet nëpër komuna janë listuar bazuar në intervista të drejtpërdrejta me përfaqësues komunal, të partive politike, shoqërisë civile, mediave dhe njohëseve të qeverisjes lokale.

disa herë ju kanë drejtuar autoriteteve me kërkesën për rregullimin e saj. Komuna e ka pasur në buxhet për të rregulluar këtë rrugë në vitin 2016, por në gjysmën e këtij viti ka rialokuar mjetet në projektet e tjera. Gjatësia e rrugës vlerësohet të jetë rreth 3.5 km.

### **Kanalizimet dhe kundërmimi i ujërave të zeza**

Qyteti i Gjilanit tani e shumë kohë përballet me problemin e rrjetit të ujërave të zeza, i cili nuk është zgjidh tërësisht edhe pas investimeve të mëdha që kanë ndodhur viteve të fundit. Gjatë këtij mandati (2013-2017), komuna ka fituar një donacion në vlerë afro 6 milionë euro për trajtimin e ujërave të zeza nga qeveria austriake. Problemi shfaqet veçmas gjatë reshjeve të shiut, qyteti shpesh vërshohet nga uji si pasojë e pamundësisë së gypave të kanalizimit për të thithur ujin. Problem me kanalizimet në Gjilan kanë edhe zonat që zyrtarisht konsiderohen se e kanë të instaluar sistemin e kanalizimeve. Banorët përgjatë rrugëve "Reshat Ymeri", "Abdullah Presheva", "Dëshmorët e Kombit" dhe "Adem Jashari" të cilat ndodhen në qendër të qytetit disa herë radhazi janë ankuar për bllokimin e shpeshtë të kanalizimeve. Banorët përkaj lumit "Stanishor", deri në hyrje të fshatit Malishevë, përballen me problemin e kundërmimit të ujërave të zeza.

### **Mungesa e çerdheve publike**

Komuna e Gjilanit ka vetëm një çerdhe publike. Komuna e Gjilanit ka pranuar gjatë vitit 2016/17 katër kërkesa zyrtare nga ana e bashkësive lokale dhe këshillave të fshatrave ku kërkohet rritja e numrit të çerdheve.

### **Mungesa e sheshit**

Nga gjithë bashkëbiseduesit në Gjilan është cekur mungesa e një sheshi të qytetit i ngjashëm me atë të Prishtinës, Ferizajt, Mitrovicës apo Pejës. Komuna nuk ka ndonjë plan për ndërtimin e ndonjë sheshi. Zona më e përshtatshme për këtë vlerësohet hapësira përball teatrit të qytetit, por për këtë kërkohet një riorganizim i komunikacionit. Të gjitha manifestimet që zhvillohen në Gjilan zhvillohen në këtë zonë dhe në të gjitha rastet autoritetet detyrohen të ndërpresin lëvizjen e automjeteve, çfarë shkakton tollovi në qytet.

## **Fushat që kërkojnë vëmendjen e komunës**

### **Funksionalizimi i plotë i shkollës së agrobiznesit**

Komuna e Gjilanit në vitin 2012 ka përfitur një donacion nga agjencia daneze "DANIDA" në vlerë dy milionë euro për ndërtimin e shkollës profesionale të agrobiznesit. Shkolla është ndërtuar dhe posedon të gjitha kushtet duke nisur nga laboratorët, kuzhinën, sallat mësimore,

hapësirat me mjete të punës si dhe hapësirën rekreative. Aktualisht në këtë shkollë zhvillohet proces mësimor vetëm në fushën praktike, jo edhe në atë teorike. Komuna duhet të kujdeset që funksionalizimi i kësaj shkolle të jetë i plotë dhe t'i shmanget praktikave të bartjes së nxënësve nga një objekt shkollor në objektin tjetër.

## **Trendet buxhetore në Komunën e Gjilanit (2017)**


Kryetari i tanishëm i komunës Lutfi Haziri në fillim të muajit gusht 2017 ka paraqitur një raport para Kuvendit Komunal ku ka treguar se komuna rrezikon në gjykata t'i humb rastet që lidhen me pagesat e shpronësimit të disa tokave, vlera e se cilave është rreth 8 milionë euro. Këto raste të adresuara në gjykatë lidhen me 80 pronarë të tokave të cilëve në vitin 1995 pushteti i atëhershëm i Serbisë u ka marr pronat për ndërtimin e rrugës në relacionin Gjilan-Bujanovc, por nuk janë kompensuar asnjëherë. Nëse gjykata vendos në favor të pronarëve, atëherë komuna e Gjilanit do të gjendet para një sfide reale buxhetore se si t'i kompensojë pronarët.

Komuna e Gjilanit në vitin 2017 ka planifikuar afro 22.7 milionë euro buxhet.<sup>6</sup> Ndërsa përveç planifikimeve të rregullta Komuna e Gjilanit ka bartur 1.3 milionë euro nga të hyrat vetanake të vitit të kaluar, kurse në vitin 2013 ishin bartur vetëm 214 mijë euro. Krahasuar me vitin 2013, Komuna e Gjilanit ka rritje të buxhetit prej afro 4.2 milionë euro. Rritja e buxhetit është bërë në kategorinë e pagave dhe investimeve kapitale, por ka pasur rënie të buxhetit në mallra dhe shërbime dhe subvencione dhe transfere. Në vitin 2013, buxheti për paga ka qenë 11,5 milionë euro, kurse më 2017 ky buxhet është për rreth tre milionë euro më i lartë (apo 27%). Ndërsa në kategorinë e investimeve kapitale, në vitin 2013, Gjilani ka pasur në dispozicion 3 milionë euro, kurse në vitin 2017, buxheti për investime kapitale është për 1.2 milionë euro më i lartë (apo 38%).

---


<sup>6</sup> Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2rMELbD>

**Figura nr.1:** Buxheti i Komunës së Gjilanit 2017




Komuna e Gjilanit vazhdimisht ka pasur një dominim të shpenzimeve në paga dhe trendi ka shkuar në rritje, përderisa investimet kapitale kanë pasur lëvizje të ndryshme, kryesisht gjatë viteve të fundit është shënuar rënie. Ndërsa krahasuar me vitin 2013, numri i të punësuarve në Komunën e Gjilanit është rritur për 32 persona në vitin 2016.

**Figura nr.2:** Trendet buxhetore në Komunën e Gjilanit 2013-2017



Komuna e Gjilanit gjatë vitit 2016 ka realizuar të hyra në vlerë prej 4,2 milionë euro. Kjo shumë është dukshëm më e madhe se të hyrat e realizuara një vit me herët. Kategoria kryesore e të hyrave në Gjilan është ajo nga tatimi në pronë.

**Figura nr.3:** Të hyrat komunale 2013-2016



**Burimi:** Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

## Rekomandimet

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerr këto veprime:

- Komuna e Gjilanit duhet të gjejë zgjidhje të menjëhershme për deponinë e mbeturinave në Velekincë.
- Komuna e Gjilanit duhet të fus për çdo vit në kategorinë e saj buxhetore subvencionimin e qendrës "Pena" që trajton fëmijët me nevojat e veçanta.
- Komuna e Gjilanit duhet të sigurojë transport falas për fëmijët me nevoja të veçanta, veçmas në relacionin nga shtëpia deri të qendra "Pena".
- Komuna e Gjilanit në katër vitet e ardhshme duhet të shoh me prioritet ndërtimin e hapësirave rekreative sportive veçmas në zonat urbane.
- Komuna e Gjilanit duhet të nis gjetjen e modeleve të përshtatshme për ndërtimin dhe funksionalizimin e çerdheve për fëmijë.



Institutiti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

**Ky projekt mbështetet nga:**



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*